

MEMORANDUM I MIRËKUPTIMIT PËR BASHKËPUNIM TË NDËRSJELLTË

7358/A

në mes të

Kolegjit UNIVERSUM

Dhe

"NËNË SHPRESO"

Kamenice

I. Qëllimi i Memorandumit

1. Përmes këtij memorandumi të mirëkuptimit palët nënshkruese kanë shprehur vullnetin dhe gatishmërinë për bashkëpunim, duke synuar ngritjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të njohurive profesionale dhe akademike, dhe ndërlidhjen e mësimit akademik me punë praktike dhe anasjelltas.

II. Fushëveprimtaria

1. Përmes këtij memorandumi të mirëkuptimit, "NËNË SHPRESO" Kamenice do t'u mundësoj studentëve të Programit të Infermierisë së Kolegjit Universum përfundimin e punës praktike, me kohëzgjatje të dakorduar në mes të palëve.
2. Me anë të këtij memorandumi të mirëkuptimit, Kolegji Universum do t'u mundësoj studentëve ndjekjen me rregull të orarit të praktikës, të përcaktuar nga "NËNË SHPRESO" Kamenice.
3. Rekomandimi i kandidatëve për punë praktike do të bëhet nga Kolegji Universum, përmes një komunikimi të rregullt dhe transparent me menaxhmentin e "NËNË SHPRESO".
4. Kolegji Universum do të siguroj që kandidatët e përzgjedhur të jenë të nivelit të kënaqshëm dhe të kenë potencial për avancim në karrierën e tyre akademike dhe profesionale.

III. Përdorimi i informatave dhe dokumentacioni

1. Palët pajtohen që çdo informacion, dokument apo të dhëna, të shkëmbyera apo të pranuar sipas këtij Memorandumi të Mirëkuptimit, do të përdoren vetëm për qëllime të lejuara dhe brenda përkufizimeve të përcaktuara me këtë dokument. Palët nuk do të shpërndajnë apo bëjnë publike asnjë informacion, dokument apo të dhëna ndonjëherë palë për qëllime tjera, jashtë përkufizimeve të përcaktuara me këtë Memorandum apo që mund të bien ndesh me frymën e këtij, pa aprovim paraprak të palës tjetër;
2. Palët do të përdorin dhe trajtojnë çdo informacion, dokument apo të dhëna si komunikim të ndërsjellë me besueshmëri të plotë;
3. Çdo mosmarrëveshje, keqkuptim në realizimin e këtij Memorandumi, do të zgjidhet në frymën e tolerancës, mirëkuptimit dhe në bazë të suazave të kodit moral.
4. Kohëzgjatja e këtij memorandumi është një vit.
5. Ky Memorandum hynë në fuqi ditën e nënshkrimit, përpos nëse parashihet ndryshe me marrëveshje nga ana e palëve të përfshira në memorandum.

Prishtine, më: 23.03.2022

PALËT NËNSHKRUESE

Kolegji UNIVERSUM


Alejtin Berisha

Drejtori Ekzekutiv



“NËNË SHPRESO” Kamenice.


Adhuna Morina
Drejtoreshë





REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
SHËRBIMI SPITALOR DHE KLINIK UNIVERSITAR I KOSOVËS -
UNIVERSITETSKA BOLNIČKA I KLINIČKA SLUŽBA KOSOVA -
THE HOSPITAL AND UNIVERSITY CLINICAL SERVICE OF KOSOVO
ARKIVI QENDROR - CENTRALNI ARHIV - CENTRAL ARCHIVE

Nr. i njësies dig	Nr. Prot.
ord. jed	4470
ord. unit	Prot. no
Nr. i tab.	Data
Bl. etj.	22.06.21
No. pa. 39	Date

PRISHTINË - PRISTINA - PRISTINA

KOLEGJII
UNIVERSUM

Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës
Univerzitetska Bolnička i Klinička Služba Kosova
Hospital and University Clinical Service of Kosovo

Kolegji Universum

Në bazë të nenit 62 paragrafit 3 të ligjit Nr.04/L-125 Për Shëndetësi, nenit 13 të Statutit të Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës, Rregullores për Përcaktimin e Kushteve dhe Organizimin e Praktikës Klinike dhe Ushtrimeve Për Studentët e Institucioneve Private të Arsimit të lartë në SHSKUK dhe Vendimin Nr. Prot:1330/2 të datës 28.05.2021 të Bordit Drejtues të SHSKUK-së, Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës dhe Kolegji Universum duke u mbështetur në vullnetin e lire të tyre, më 22.06.2021, në Prishtinë Republika e Kosovës, lidhin këtë:

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

PËR

REALIZIMIN DHE ORGANIZIMIN E PRAKTIKËS KLINIKE DHE USHTRIMEVE PËR STUDENTËT E KOLEGJIT UNIVERSUM NË SHËRBIMIN SPITALOR DHE KLINIK UNIVERSITAR TË KOSOVËS.

Palët e marrëveshjes:

- Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës këtu e tutje SHSKUK, me adresë: Lagjia e Spitalit, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës, i përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm Dr.Valbon Krasniqi dhe
- Kolegji Universum, me adresë: Magjistrallja Prishtinë-Ferizaj km 10, Republika e Kosovës, i përfaqësuar nga Drejtori Ekzekutiv z.Alejtin Berisha

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i kësaj marrëveshje të bashkëpunimit është ofrimi përkatësisht marrja e shërbimeve për realizimin praktikës klinike dhe ushtrimeve për studentët e Kolegjit Universum në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës këtu e tutje QKUK.

Neni 2

Fushëveprimi

Dispozitat e kësaj marrëveshje zbatohen për studentët e Kolegjit Universum, programet e studimit të të cilëve janë të licencuara dhe të akredituara sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës të cilët kryejnë praktikën klinike dhe ushtrimet sipas kësaj marrëveshje në SHSKUK.

Dispozitat e kësaj marrëveshje zbatohen edhe për stafin e njësisë përbërëse të SHSKUK-së në të cilën zhvillohet praktika klinike dhe ushtrimet sipas kësaj marrëveshje dhe mentorët klinik të angazhuar në pajtim me këtë marrëveshje.

Neni 3

Objekti i marrëveshjes

Objekt i kësaj marrëveshje të bashkëpunimit është përcaktimi i të drejtave dhe detyrave që dalin nga realizimi i praktikës klinike dhe ushtrimeve zbatohen për studentët e Kolegjit Universum, programet e studimit të të cilëve janë të licencuara dhe të akredituara sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës të cilët kryejnë praktikën klinike dhe ushtrimet sipas kësaj marrëveshje në SHSKUK.

Neni 4

Kohëzgjatja e Marrëveshjes

1. Kjo marrëveshje hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe zgjat deri në përfundim të vitit akademik 2020-2021.
2. Afati i kësaj marrëveshje bashkëpunimi, nga paragrafi 1. i këtij neni, mund të zgjatet me aneks marrëveshje të re.

Neni 5

Praktika Klinike në SHSKUK

1. SHSKUK merr përsipër që të mundësojë kryerjen e praktikës dhe ushtrimeve për studentët e programit të Infermierisë të Kolegjit Universum sipas kushteve të përcaktuara në këtë marrëveshje dhe legjislacionin në fuqi.
2. Praktika klinike sipas paragrafit 1 të këtij neni organizohet në pajtim të plotë me planin e punës të SHSKUK-së.
3. Praktika klinike në SHSKUK për studentët e programit për studentët e programit të Infermierisë të Kolegjit Universum organizohet çdo ditë sipas plan programit të hartuar nga

mentori klinik në bashkëpunim me Kolegjin Universum dhe të aprovuar nga Drejtori për Arsim dhe Shkencë i SHSKUK-së.

4. Kohëzgjatja e praktikës klinike përcaktohet me nenin 4 të kësaj marrëveshje.

Neni 6

Obligimet e SHSKUK-së

1. SHSKUK është i obliguar që të ofrojë kushtet dhe hapsirat e nevojshme që mundësojnë kryerjen e praktikës klinike sipas kësaj marrëveshje.
2. SHSKUK, përmes Drejtorit për Arsim dhe Shkencë, mbikqyrë organizimin dhe koordinimin e punëve dhe mbarvajtjes së punës praktike për studentët e Kolegjit Universum.
3. SHSKUK, me pëlqimin e studentit/es, mund të angazhojë atë në procesin e punës, kryesisht në funksione ndihmëse të cilat përkojnë me zhvillimin dhe njohuritë e studentit.
4. Studentët që kryejnë praktike klinike dhe ushtrime, sipas kësaj marrëveshje, nuk kanë të drejtë të ndërmarrin asnjë veprim profesional në pacientët e SHSKUK-së, pa mbikqyrjen e mentorit.
5. SHSKUK, mbanë evidencë dhe lëshon vërtetim për kryerjen e punës praktike për studentin/en që ka përfunduar me rregull praktikën klinike.

Neni 7

Obligimet e Kolegjit Universum

1. Kolegji Universum përgatitë dhe harton listën e studentëve që do të kryejnë praktikën në SHSKUK dhe mban përgjegjësi për të.
2. Nëse studentët e Kolegjit Universum, gjatë kryerjes së praktikës klinike dhe ushtrimeve në SHSKUK, shkaktojnë dëm në aparaturat apo hapsirat e SHSKUK-së, Kolegji Universum është i obliguar që të bëjë kompensimin e atij dëmi në tërësi sipas evidentimit dhe dokumentimit të dëmit të shkaktuar.
3. Kolegji Universum ka për obligim që të caktojë personin përgjegjës për organizimin dhe koordinimin e punëve, i cili në bashkëpunim me Drejtorin për Arsim dhe Shkencë në kuadër të SHSKUK-së, do të harmonizojnë planin e kryerjes së praktikës klinike dhe ushtrimeve me planin e punës në SHSKUK.

Neni 8

Kushtet e përgjithshme për realizimin e praktikës klinike në SHSKUK

1. Kolegji Universum duhet të njoftojë të gjithë studentët, të cilët do të realizojnë praktikën klinike dhe ushtrimet në SHSKUK, për detyrat, përgjegjësitë dhe sjelljet e tyre gjatë realizimit të detyrave të tyre përkatëse.
2. Drejtori për Arsim dhe Shkencë i SHSKUK-së, sipas kësaj marrëveshje dhe personi përgjegjës nga Kolegji Universum, merren vesh për harmonizimin e plan programit realizimit të praktikës për studentët e Kolegjit Universum.
3. Organizimi i praktikës klinike sipas kësaj marrëveshje nuk duhet të pengojë procesin e punës në njësitë përbërëse dhe organizative në SHSKUK.
4. SHSKUK merr përsipër organizimin e pjesës praktike në lëmin e lëndëve paraklinike dhe klinike në njësitë përbërëse të tij për studentët e Kolegjit Universum.
5. Studentët e Kolegjit Universum, të cilët kryejnë praktikën klinike në SHSKUK, sipas kësaj marrëveshje, kanë për obligim që gjatë kryerjes së praktikës të mbajnë veshur uniforma standarde të cilat duhet të kenë llogon e Kolegjit Universum.
6. Drejtori për Arsim dhe Shkencë në SHSKUK, në bashkëpunim me koordinatorin e caktuar nga Kolegji Universum, caktojnë mentorët dhe stafin tjetër sipas nevojës për organizimin e praktikës klinike dhe ushtrimeve për studentët e Kolegjit Universum në pajtim me legjisllacionin në fuqi.
7. Drejtori për Arsim dhe Shkencë në SHSKUK, përmes mentorëve klinikë, përcjell vijueshmërinë e studentëve të programeve përkatëse të Kolegjit Universum dhe në rast të më shumë se tre (3) mungesa pa arsye dhe më shumë se dhjetë (10) mungesa të tjera, atëherë studenti/ja nuk mund të marrë vërtetimin për kryerjen e praktikës klinike në SHSKUK.

Neni 9

Kushtet e veçanta për realizimin e praktikës klinike në Shërbimin Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës

1. Numri i lejuar i studentëve që kryejnë praktikë klinike dhe ushtrime në SHSKUK, përcaktohet me vendimin përkatës të Agjencionit të Kosovës për Akreditim.
2. Numri i studentëve të Kolegjit Universum që do të kryejnë praktikën klinike dhe ushtrimet në SHSKUK është si vijon:
 - 2.1. Programi Infermieri sipas vendimit të Agjencionit të Kosovës për Akreditim (bashkëngjitur kësaj marrëveshje);

Neni 10
Mentorët klinik

1. Mentorët klinik që angazhohen sipas kësaj marrëveshje, duhet që të jenë në marrëdhënie pune me QKUK.
2. Kolegji Universum, është i obliguar që të paguajë angazhimin e mentorit përkatës, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Neni 11
Mbikqyrja e zbatimit të marrëveshjes

1. Autoritet mbikqyrës i zbatimit të kësaj marrëveshje, për QKUK-në është Drejtori për Arsim dhe Shkencë i SHSKUK-së, Drejtori i Klinikës përkatëse.
2. Për Kolegjin Universum koordinatori i caktuar sipas kësaj marrëveshje.

Neni 12

1. Nëse palët e kësaj marrëveshje, dëshirojnë që të ndryshojnë kushtet nga kjo marrëveshje, atëherë, palët mund t'i bëjnë këto ndryshime me marrëveshjen e dy palëve, me njoftim paraprak prej tridhjetë (30) ditëve kalendarike.
2. Në rast kontesti të mundshëm në mes të palëve të kësaj marrëveshje lidhur me dispozitat e kësaj marrëveshje, kompetente për zgjidhjen e tij është Gjykata Themelore në Prishtinë.

Neni 13

1. Kjo marrëveshje është e hartuar në katër (4) kopje origjinale nga dy (2) për secilën nga palët e saj.

Neni 14
Dispozitat shfuqizuese

Dispozitat e kësaj marrëveshje shfuqizojnë çdo marrëveshje tjetër të lidhur për qëllimin e njejtë mes palëve nënshkruese të kësaj marrëveshje.

Neni 15

Hyrja në fuqi

Kjo marrëveshje hyn në fuqi më 22.06.2021.

PALËT NËNSHKRUESE:


Dr. Valbon Krasniqi
Drejtor i Përgjithshëm i ShSKUK-së


z. Alejtin Berisha
Drejtor Ekzekutiv i Kolegjit Universum



MEMORANDUM I MIRËKUPTIMIT PËR BASHKËPUNIM TË NDËRSJELLTË

në mes të

Kolegjit UNIVERSUM

Dhe

PREMIUM HOSPITAL

I. Qëllimi i Memorandumit

1. Përmes këtij memorandumi të mirëkuptimit palët nënshkruese kanë shprehur vullnetin dhe gatishmërinë për bashkëpunim, duke synuar ngritjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të njohurive profesionale dhe akademike, dhe ndërlidhjen e mësimit akademik me punë praktike dhe anasjelltas.

II. Fushëveprimtaria

1. Përmes këtij memorandumi të mirëkuptimit, Premium Hospital në Prishtinë do t'u mundësoj studentëve të Programit të Infermierisë së Kolegjit Universum përfundimin e punës praktike, me kohëzgjatje të dakorduar në mes të palëve.

Me anë të këtij memorandumi të mirëkuptimit, Kolegji Universum do t'u mundësoj studentëve ndjekjen me rregull të orarit të praktikës, të përcaktuar nga Premium Hospital Prishtinë

2. Rekomandimi i kandidatëve për punë praktike do të bëhet nga Kolegji Universum, përmes një komunikimi të rregullt dhe transparent me menaxhmentin e Premium Hospital.
4. Kolegji Universum do të siguroj që kandidatët e përzgjedhur të jenë të nivelit të kënaqshëm dhe të kenë potencial për avancim në karrierën e tyre akademike dhe profesionale.

III. Përdorimi i informatave dhe dokumentacioni

1. Palët pajtohen që çdo informacion, dokument apo të dhëna, të shkëmbyera apo të pranuar sipas këtij Memorandumi të Mirëkuptimit, do të përdoren vetëm për qëllime të lejuara dhe brenda përkufizimeve të përcaktuara me këtë dokument. Palët nuk do të shpërndajnë apo bëjnë

publike asnjë informacion, dokument apo të dhëna ndonjëherë palë për qëllime tjera, jashtë përkufizimeve të përcaktuara me këtë Memorandum apo që mund të bien ndesh me frymën e këtij, pa aprovim paraprak të palës tjetër;

2. Palët do të përdorin dhe trajtojnë çdo informacion, dokument apo të dhëna si komunikim të ndërsjelltë me besueshmëri të plotë;

3. Çdo mosmarrëveshje, keqkuptim në realizimin e këtij Memorandumi, do të zgjidhet në frymën e tolerancës, mirëkuptimit dhe në bazë të suazave të kodit moral.

4. Kohëzgjatja e këtij memorandumi është pa afat kohor.

5. Ky Memorandum hynë në fuqi ditën e nënshkrimit, përpos nëse parashihet ndryshe me marrëveshje nga ana e palëve të përfshira në memorandum.

Prishtine, më: 14.09.2022


PALET NËNSHKRUESE


Kolegji UNIVERSUM


Alejtin Berisha
Drejtori Ekzekutiv



PREMIUM HOSPITAL


Shpend Ramadani
Drejtori Ekzekutiv



MEMORANDUM I MIRËKUPITIMIT PËR BASHKËPUNIM TË NDËRSJELLTË

në mes të

Kolegjit UNIVERSUM

dhe

Qendres Kryesore të Mjeksisë Familjare – Gjilan

Qëllimi i Memorandumit

1. Përmes këtij memorandumi të mirëkuptimit palët nënshkruese kanë shprehur vullnetin dhe gatishmërinë për bashkëpunim, duke synuar ngritjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të njohurive profesionale dhe akademike, dhe ndërlidhjen e mësimit akademik me punë praktike dhe anasjelltas.

II. Fushëveprimtaria

1. Përmes këtij memorandumi të mirëkuptimit, Qendra Kryesore e Mjeksisë Familjare në Gjilan do t'u mundësoj studentëve të Programit të Infermierisë së Kolegjit Universum përfundimin e punës praktike, me kohëzgjatje të dakorduar në mes të palëve.
2. Me anë të këtij memorandumi të mirëkuptimit, Kolegji Universum do t'u mundësoj studentëve ndjekjen me rregull të orarit të praktikës, të përcaktuar nga QKMF Gjilan.
3. Rekomandimi i kandidatëve për punë praktike do të bëhet nga Kolegji Universum, përmes një komunikimi të rregullt dhe transparent me menaxhmentin e QKMF-së.
4. Kolegji Universum do të siguroj që kandidatët e përzgjedhur të jenë të nivelit të kënaqshëm dhe të kenë potencial për avancim në karrierën e tyre akademike dhe profesionale.

III. Përdorimi i informatave dhe dokumentacioni

1. Palët pajtohen që çdo informacion, dokument apo të dhëna, të shkëmbyera apo të pranuar sipas këtij Memorandumi të Mirëkuptimit, do të përdoren vetëm për qëllime të lejuara dhe


brenda përkufizimeve të përcaktuara me këtë dokument. Palët nuk do të shpërndajnë apo bëjnë publike asnjë informacion, dokument apo të dhëna ndonjëherë palë për qëllime tjera, jashtë përkufizimeve të përcaktuara me këtë Memorandum apo që mund të bien ndesh me frymën e këtij, pa aprovim paraprak të palës tjetër;

2. Palët do të përdorin dhe trajtojnë çdo informacion, dokument apo të dhëna si komunikim të ndërsjellë me besueshmëri të plotë;
3. Çdo mosmarrëveshje, keqkuptim në realizimin e këtij Memorandumi, do të zgjidhet në frymën e tolerancës, mirëkuptimit dhe në bazë të suazave të kodit moral.
4. Kohëzgjatja e këtij memorandumi është tre vjet.
5. Ky Memorandum hynë në fuqi ditën e nënshkrimit, përpos nëse parashihet ndryshe me marrëveshje nga ana e palëve të përfshira në memorandum.

Prishtine, më: 18.03.2022

PALËT NËNSHKRUESE

Kolegji UNIVERSUM


Alejtin Berisha
Drejtori Ekzekutiv



QKME
Dr. Arbenita Bajdani
Mënyrë Familjare
KO-00-25.07.21
0022

Drejtoreshë





MEMORANDUM I MIRËKUPITIMIT PËR BASHKËPUNIM TË NDËRSJELLTË

në mes të

Kolegjit UNIVERSUM

dhe

Qendres Kryesore të Mjeksisë Familjare – Suharekë

Qëllimi i Memorandumit

1. Përmes këtij memorandumi të mirëkuptimit palët nënshkruese kanë shprehur vullnetin dhe gatishmërinë për bashkëpunim, duke synuar ngritjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të njohurive profesionale dhe akademike, dhe ndërlidhjen e mësimit akademik me punë praktike dhe anaşjelltas.

II. Fushëveprimtaria

1. Përmes këtij memorandumi të mirëkuptimit, Qendra Kryesore e Mjeksisë Familjare në Suharekë do t'u mundësoj studentëve të Programit të Infermierisë së Kolegjit Universum përfundimin e punës praktike, me kohëzgjatje të dakorduar në mes të palëve.
2. Me anë të këtij memorandumi të mirëkuptimit, Kolegji Universum do t'u mundësoj studentëve ndjekjen me rregull të orarit të praktikës, të përcaktuar nga QKMF Suharekë.
3. Rekomandimi i kandidatëve për punë praktike do të bëhet nga Kolegji Universum, përmes një komunikimi të rregullt dhe transparent me menaxhmentin e QKMF-së.
4. Kolegji Universum do të siguroj që kandidatët e përzgjedhur të jenë të nivelit të kënaqshëm dhe të kenë potencial për avancim në karrierën e tyre akademike dhe profesionale.

III. Përdorimi i informatave dhe dokumentacioni

1. Palët pajtohen që çdo informacion, dokument apo të dhëna, të shkëmbyera apo të pranuar sipas këtij Memorandumi të Mirëkuptimit, do të përdoren vetëm për qëllime të lejuara dhe

brenda përkufizimeve të përcaktuara me këtë dokument. Palët nuk do të shpërndajnë apo bëjnë publike asnjë informacion, dokument apo të dhëna ndonjëherë palë për qëllime tjera, jashtë përkufizimeve të përcaktuara me këtë Memorandum apo që mund të bien ndesh me frymën e këtij, pa aprovim paraprak të palës tjetër;

2. Palët do të përdorin dhe trajtojnë çdo informacion, dokument apo të dhëna si komunikim të ndërsjellë me besueshmëri të plotë;

3. Çdo mosmarrëveshje, keqkuptim në realizimin e këtij Memorandumi, do të zgjidhet në frymën e tolerancës, mirëkuptimit dhe në bazë të suazave të kodit moral.

4. Kohëzgjatja e këtij memorandumi është tre vjet.

5. Ky Memorandum hynë në fuqi ditën e nënshkrimit, përpos nëse parashihet ndryshe me marrëveshje nga ana e palëve të përfshira në memorandum.

Prishtine, më: 11.02.2022

PALËT NËNSHKRUESE

Kolegji UNIVERSUM

Alejtin Berisha
Drejtori Ekzekutiv

